Numër: 08/01 Datë: 05.01.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), merr:

V E N D I M

I. **Refuzohet** kërkesa për akreditim dhe validim e institucionit "Kolegji Europian i Kosovës", me adresë Rr. "Gustav Mayer" Nr. 19 dhe Rr. "Edmond Hoxha" Nr. 65, Prishtinë, Kosovë, për realizimin e kualifikimit:

- **Operuesit e Impianteve të Vinçave, Ngritjeve dhe të Ngjashëm** - Niveli III i KKK / Kualifikim i bazuar në Kualifikime Kombëtare Profesionale, me numër total të kredive 4.

III. Institucioni mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së paraqitur nga institucioni **"Kolegji Europian i Kosovës"** pranë **Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK)** për akreditimin dhe validimin e kualifikimit **"Operuesit e Impianteve të Vinçave, Ngritjeve dhe të Ngjashëm"**, AKK, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka emëruar ekipet e ekspertëve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të përmbushjes së kritereve përkatëse.

Ekipi i ekspertëve ka shqyrtuar dosjen e aplikimit të datës 04.06.2025 për akreditimin e kualifikimit **"Operuesit e Impianteve të Vinçave, Ngritjeve dhe të Ngjashëm"**, Niveli III sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK). Vizita vlerësuese në institucion është realizuar më 23.06.2025, ndërsa raportet përfundimtare të vlerësimit janë hartuar më 29.07.2025.

Tutje, ekipi i ekspertëve, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit të kushteve gjatë vizitës në institucion, gjendjes së klasave për zhvillimin e mësimit teorik dhe praktik, kontratave të bashkëpunimit me kompani, përmbajtjes së programit të kualifikimit si dhe numrit të përgjithshëm të orëve mësimore, ka konstatuar se kapacitetet institucionale nuk janë të mjaftueshme për realizimin e procesit të formimit dhe certifikimit të grupeve të kandidatëve.

Numri i kandidatëve për një cikël certifikimi, sipas dokumentacionit të paraqitur nga Kolegji Europian i Kosovës, nuk konsiderohet i realizueshëm as nga aspekti kohor dhe as nga ai infrastrukturor, përfshirë edhe burimet njerëzore në dispozicion.

Gjithashtu, institucioni në dosjen e dokumenteve shtesë ka dorëzuar disa teste dhe lista kontrolli, të cilat vetëm pjesërisht i përmbushin standardet e kërkuara. Mungojnë testet dhe listat e kontrollit për vlerësimin përfundimtar, si për pjesën teorike, ashtu edhe për atë praktike të kualifikimit.

Për më tepër, institucioni nuk ka ndërmarrë përmirësimet e sugjeruara nga paneli vlerësues gjatë procesit të vlerësimit, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejt në marrjen e vendimit për refuzimin e akreditimit të këtij kualifikimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmitë dhe dokumentacionin e ofruar nga institucioni në fazën e aplikimit, përfshirë: aplikacionet për validimin e kualifikimeve, aplikacionet për akreditimin e institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, si dhe gjetjet e konstatuara gjatë realizimit të vizitave vlerësuese pranë palës aplikuese.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare **dhe** nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 – Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, është i obliguar të realizojë procesin e monitorimit dhe të raportojë pranë Këshillit Drejtues të AKK-së.

Bazuar në analizën e dokumentacionit të aplikimit, gjetjet nga vizita vlerësuese në terren, si dhe raportet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve, çështja është proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të mbajtur më 22.12.2025.

Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- ''Kolegji Europian i Kosovës'';
- Arkivit të AKK.